

# PHILIPS

## Radio Portative

The Janet XL

TAV2500F



# Manuali i Përdoruesit

Regjistroni produktin tuaj dhe përfitoni mbështetje në:  
[www.philips.com/support](http://www.philips.com/support)

## Përmbajtja

<b>1 E rëndësishme</b>	<b>2</b>	<b>7 Dëgjoni muzikë me Bluetooth®</b>	<b>10</b>
Siguria	2	Lidhni Bluetooth®	10
Njoftim	2	Shkëput Bluetooth®-in	10
Markat tregtare	3	Fshini të dhënat e çiftimit Bluetooth®	10
<b>2 Radioja juaj portative</b>	<b>3</b>	Luaj muzikë	10
Hyrje	3	Shfaq menunë në modalitetin Bluetooth®	10
Çfarë ka në kuti	3	Riprodhoni nga Auracast™	12
Shkarkoni aplikacionin	3	<b>8 Veçori të tjera</b>	<b>13</b>
Çiftoni Aplikacionin me radion tuaj	4	Vendos kohëmatësin e kuzhinës	13
Përmbledhje e radios portative	4	Ndaloni tingujt e kohëmatësit të kuzhinës	13
Zëvendësoni bateritë	4	Anuloni kohëmatësin e kuzhinës	13
<b>3 Fillo</b>	<b>5</b>	Telekomanda virtuale (vetëm përmes aplikacionit)	13
Ngarkoni baterinë e integruar	5	Përditësimi i firmuerit	14
Ndizeni/fikeni ose kaloni në modalitetin e pritjes	5	Udhëzuesi i përdoruesit	14
Zgjidhni gjuhën e menusë	5	Rikthim ne gjendjen e parametrave të vendosur nga fabrika	14
Rregulloni volumin	5	<b>9 Specifikat e produktit</b>	<b>15</b>
Rregulloni ndriçimin e ekranit	6	<b>10 Zgjidhja e problemeve</b>	<b>15</b>
Shfaqja e menusë në modalitetin e pritjes	6	<b>11 Informacioni i FCC</b>	<b>16</b>
<b>4 Cilësimi/konfigurimi i orës</b>	<b>7</b>		
Vendosja automatike e orës	7		
Vendosja manuale e orës	7		
Vendosni formatin e kohës	7		
Vendosni formatin e dates	7		
Stili i orës	7		
<b>5 Vendosja e alarmit</b>	<b>8</b>		
Vendosja e kohës së alarmit	8		
Aktivizoni/çaktivizoni kohëmatësin e alarmit	8		
<b>6 Dëgjoni radion FM</b>	<b>8</b>		
Sintonizimi automatik	8		
Kërkimi manual	8		
Kërkoni dhe ruani automatikisht stacionet e radios FM	8		
Ruani në mënyrë manuale stacionet e radios me valë FM	8		
Zgjidhni një stacion radioje të paracaktuar	9		
Cilësimi i ndjeshmërisë së skanimit	9		
Shfaq informacionin RDS	9		
Shfaq menunë në modalitetin FM	9		

## Siguria

- Lexoni këto udhëzime.
- Merrni parasysh dhe respektoni të gjitha paralajmërimet.
- Ndiqni të gjitha udhëzimet.
- Mos bllokoni asnjë hapje ventilimi.
- Mos bëni instalime pranë ndonjë burimi nxehtësie, si radiatorë, dalje të ajrit të ngrohtë, soba ose pajisje të tjera (ku përfshihen edhe amplifikatorët) që prodhojnë nxehtësi.
- Mbajeni këtë aparat larg nga rrezet direkte të diellit, flakët në ambiente të hapura ose burimet e nxehtësisë.
- Produkti nuk duhet t'i ekspozohet pikimit ose spërkatjes të ujit.
- Vendoseni këtë produktin në një sipërfaqe të sheshtë, të fortë dhe të qëndrueshme.
- Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi produktin (p.sh. objekte të mbushura me lëng, qirinjtë të ndezur).
- Mos vendosni kurrë këtë aparat mbi pajisje të tjera elektrike.
- Përdorni vetëm kapëse/pajisje shtesë të specifikuar nga prodhuesi. Asnjëherë mos e hiqni kapakun/veshjen e jashtme të kësaj pajisjeje. I kryeni të gjitha servisimet vetëm te personeli i kualifikuar i shërbimit. Servisimi kërkohet kur produkti është dëmtuar në çfarëdo mënyre, si p.sh. kordoni i furnizimit me energji elektrike ose prize ka pësuar dëmtim, lëng është derdhur mbi të ose objektet kanë rënë në produkt, vetë produkti i është ekspozuar shiut ose lagështisë, nuk funksionon normalisht, ose ka rënë në tokë.
- Bateria (paketa e baterisë ose bateritë e instaluara) nuk duhet të ekspozohen ndaj nxehtësisë së tepërt si rrezet e diellit, ndaj zjarrit ose të ngjashme me to.
- Rrezik shpërthimi nëse bateritë nuk zëvendësohen në mënyrën e duhur. Zëvendësoni vetëm me të njëjtin lloj ose ekuivalent me të.
- Bateria në temperatura ekstremisht të larta ose të ulëta gjatë përdorimit, ruajtjes ose transportit si dhe nga presioni i ulët i ajrit në lartësi të madhe mund të krijojë rreziqe për sigurinë.
- Rrezik shpërthimi nëse një bateri zëvendësohet nga një lloj i gabuar.
- Shmagni zëvendësimin e bateri së me llojin e gabuar që mund të prishë mbrojtjen (për shembull, disa lloje baterish litiumi).
- Instaloni të gjitha bateritë në mënyrë korrekte.
- Lënia e një baterie në një mjedis me temperaturë jashtëzakonisht të lartë ose në një mjedis me presion jashtëzakonisht të ulët ajri mund të rezultojë në një shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të ndezshëm.
- Bateritë përmbajnë substanca kimike. Ato duhet të asgjësohen në mënyrën e duhur.
- Nëse dyshoni se një bateri është gëlltitur ose vendosur brenda ndonjë pjese të trupit, kërkoni ndihmën e menjëhershme mjekësore.
- Kur ndërroni bateritë, mbajini gjithmonë të gjitha bateritë e reja dhe të përdorura larg fëmijëve. Sigurohuni që dhomëza e baterisë të jetë plotësisht e sigurt pasi të keni zëvendësuar baterinë.
- Nëse dhomëza e baterisë nuk mund të jetë e sigurt tërësisht, ndërprisni përdorimin e produktit. Mbajeni larg fëmijëve dhe kontaktini prodhuesin.
- Produkti nuk duhet t'i ekspozohet pikimit ose spërkatjes të ujit.
- Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi produktin (p.sh. objekte të mbushura me lëng, qirinjtë të ndezur).
- Përdoreni produktin në mënyrë të sigurt në një mjedis me temperaturë midis 0°C dhe 40°C.



- Për të shmangur rrezikun e zjarrit, pajisja furnizohet vetëm nga burimi i jashtëm i furnizimit me energji, prodhimi i të cilit duhet të jetë në përputhje me PS1 (me kapacitet dalës më të ulët se 15 W).
- Energjia e furnizuar nga ngarkuesi dhe që kërkohet nga pajisja radio duhet të jetë ndërmjet minimumit prej 5 Vat dhe maksimumit prej 15 Vat me qëllim që të arrihet shpejtësia maksimale e ngarkimit.

 Simboli tregon tensionin DC (rrymën e drejtpërdrejtë)

## Politika e raportimit të cenueshmërisë

Ne i kushtojmë rëndësi sigurisë së produkteve dhe mirëpresim raportimin e çdo cenueshmërie që ju mund të gjeni.

### 1: Hapat e raportimit

Përshkruani në mënyrë të detajuar cenueshmërinë, duke përfshirë llojin e saj, ndikimin dhe metodën e riprodhimit. Siguroni materiale mbështetëse, të tilla si pamje të ekranit, regjistra/logs. Mbajeni informacionin konfidencial dhe mos ia zbuloni atë një pale të tretë.

### 2: Kanalet e raportimit

Ju lutemi dërgoni email në: Philips.com

### 3: Ndjekja e raportimit

Ne do t'ju përgjigjemi dhe do t'ju komunikojmë çështjet e ndjekjes në kohë. Raportimet e sakta dhe të vlefshme mund të shpërblehen. Raportimet me qëllim të keq do të sjellin përgjegjësi ligjore.

## 4: Trajtimi i cenueshmërisë

Ne do ta vlerësojmë dhe korrigjohmë cenueshmërinë.

Pas korrigjimit të cenueshmërisë, ne do të vendosim, sipas rastit, nëse informacioni mbi cenueshmërinë do të bëhet publik.

## 5: Mbrojtja dhe Shpërblimi

Ne do ta mbajmë konfidencial identitetin e raportuesit. Ju lutemi shmangni përfshirjen e informacionit të ndjeshëm në raportin tuaj. Në varësi të natyrës së cenueshmërisë, ne mund të ofrojmë shpërblime. Zbatoni ligjin, raportoni në mënyrë të ligjshme dhe shmangni çdo sjellje keqdashëse.

## Politika e përditësimit të sigurisë së produktit

1. Ne jemi të përkushtuar të kryejmë një kontroll sigurie të firmuerit të pajisjes të paktën një herë në gjashtë muaj dhe të publikojmë përditësime sa herë që zbulohen cenueshmëri të sigurisë ose bëhen përmirësime të rëndësishme të sigurisë.
2. Pas publikimit të çdo përditësimi të firmuerit, ne do të ofrojmë një periudhë minimale prej 30 ditësh për shkarkimin e tij, për të siguruar që përdoruesit të kenë kohë të mjaftueshme për ta instaluar përditësimin.
3. Përditësimet e sigurisë së softuerit do të mbështeten deri në dhjetor 2030. Pajisjet që kanë tejkaluar periudhën e mbështetjes nuk do të marrin më përditësime zyrtare të sigurisë.

## Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim i bërë në këtë pajisje që nuk është miratuar shprehimisht nga MMD Hong Kong Holding Limited mund të anulohet autoritetin e përdoruesit për të përdorur produktin.

## Përputhshmëria

Nëpërmjet këtij dokumenti, TP Vision Europe B.V. deklaron se produkti është në përputhje me kërkesat bazë dhe dispozitat e tjera përkatëse të Direktivës RED 2014/53/EU dhe UK Radio Equipment Regulations SI 2017 No 1206. Deklarata e Konformitetit mund të gjendet në [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).

## Kujdesi për mjedisin

### Asgjësimi i produktit dhe baterisë tuaj të vjetër



Produkti juaj është konceptuar dhe prodhuar me materiale dhe përbërës të cilësisë së lartë, të cilët mund të riciklohen dhe ripërdoren.



Ky simbol në një produkt do të thotë që produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol nënkupton se produkti përmban bateri të mbuluara nga Rregullorja Evropiane (EU) 2023/1542, të cilat nuk mund të hidhen me mbeturinat e zakonshme shtëpiake.

Informohuni për sistemin lokal të grumbullimit të veçantë për produktet dhe bateritë elektrike dhe elektronike. Ndiqni rregullat lokale dhe mos e hidhni kurrë produktin dhe bateritë me mbeturinat e zakonshme shtëpiake. Asgjësimi i duhur e produkteve dhe baterive të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

### Hiqni baterinë e integruar

Për heqjen e baterive të integruara, referojuni seksionit Instalimi i baterive.

### Informacion mjedisor

Janë hequr të gjitha paketimet e panevojshme. Sistemi juaj përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi respektoni rregulloret lokale në lidhje me asgjësimin e materialeve të paketimit, baterive të shëruara dhe pajisjeve të vjetra.

## Markat tregtare



Emri dhe logot Auracast™ janë marka tregtare të pronësisë së Bluetooth SIG, Inc., dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat dhe emrat e tjerë tregtarë janë ato të pronarëve të tyre përkatës.



Marka e fjalës dhe logot Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara në pronësi të Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë.



Krijimi i kopjeve të paautorizuara të materialeve të mbrojtura nga kopjimi, duke përfshirë programe kompjuterike, skedarë, transmetime dhe regjistrime zanore, mund të shkelë të drejtat e autorit dhe të përbëjë një veprë penale. Kjo pajisje nuk duhet të përdoret për qëllime të tilla.

## 2 Radioja juaj portative

Urime për blerjen tuaj dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që ofron Philips, regjistrojeni produktin tuaj në [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).



### Hyrje

Me këtë radio portative, mund të dëgjoni stacione radioje në FM, si dhe të luani muzikë përmes Bluetooth-it ose USB-së.

### Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe identifikoni përmbajtjen e pakos tuaj:

- Njësia kryesore
- Kablli i karikimit TIPI-C
- Udhëzues për fillimin e shpejtë / fletë sigurie / garanci



### Shënim

- Imazhet, ilustrimet dhe vizatimet e treguara në këtë manual përdorimi janë vetëm për referencë. Produkti aktual mund të jetë i ndryshëm në pamje.

Aplikacioni ynë i përshtatshëm shoqëruet ju mundëson të zgjidhni burimin e sinjalit, të kontrolloni riprodhimin dhe funksionin Bass+, të monitoroni nivelin e baterisë dhe të përdorni shumë funksione të tjera shitesë. Gjithashtu, aplikacioni përmban një funksion "PartyLink", që të lejon të lidhesh lehtësisht me autoparlantë të tjerë përmes teknologjisë Auracast™, për një tingull edhe më të fuqishëm.


### Shkarkoni aplikacionin

Skanoni kodin QR/shtypni butonin "Shkarko" ose kërkoni "Philips Entertainment" në Apple App Store ose Google Play për të shkarkuar aplikacionin.




## Çiftoni Aplikacionin me radion tuaj

Hapni Aplikacionin Philips Entertainment në pajisjen tuaj celulare, shtypni 'Add device +' për të zbuluar këtë radio (The Janet XL). Sigurohuni që Bluetooth të jetë i aktivizuar në celularin tuaj. Ndiqni udhëzimet në ekran për të konfirmuar çiftimin.



Pasi radioja juaj të jetë e lidhur me Aplikacionin Entertainment, mund të shijoni funksione shtesë dhe të konfiguroni lehtësisht preferencat tuaja.

## Përmbledhje e radios portative




- Shtypni shkurt për të hyrë në MENU/dalë nga MENU-ja ose për t'u kthyer në menunë e mëparshme.
- Shtypje e shkurtër: Ulni frekuencën (MHz) / Kaloni te pjesa muzikore e mëparshme.  
Shtypje e gjatë: Kryeni skanim automatik në drejtim zbritës për të kërkuar një stacion radioje.
- Shtypni për të hyrë në menunë e burimit.
- Përdorni dorezën rrotulluese për të rregulluar nivelin e vullmit ose për të lëvizur ndërmjet opsioneve të menisë. Shtypni për të zgjedhur një opsion menuje, për të skanuar ose menaxhuar stacionet radiofonike, ose për të nisur/ndaluar riprodhimin përmes Bluetooth-it ose USB-së.
- Shtypje e shkurtër: Rrit frekuencën (MHz) / Kalo te pjesa tjetër muzikore.  
Shtypje e gjatë: Kryen skanim automatik në drejtim ngjites për të kërkuar një stacion radioje.

4 SQ


- Radio të Preferuara  
Shtypni shkurt për të hyrë në listën e paracaktuar të 'Të Preferuarave'. Shtypni gjatë për të shtuar ose hequr një stacion radioje nga lista e "Të Preferuarave".
- Shtypje e shkurtër: Ndiz pajisjen / Kalo në modalitetin e pritjes/ Çaktivizo alarmin.  
Shtypje e gjatë: Fikja
- Marrës Auracast
- Portë karikimi USB tip C / Riprodhim audio përmes USB-së
- Antenë

## Zëvendësoni bateritë

- Hapni kapakun e baterisë në pjesën e poshtme të radios dhe nxirri baterinë origjinale nga hapësira e saj.



- Vendosni një bateri të të njëjtit lloj (nuk përfshihet).



- Mbyllni kapakun e baterisë.

Nëse dëshironi të blini bateri shtesë, ju lutemi vizitoni <https://www.philips.com>  
Bateri e Rikarikueshme Litium-Jon  
Modeli: TACR5003BA  
Kapaciteti nominal: 7,3V, 2600mAh, 18,98Wh Maks.  
Tensioni i Ngarkimit: 8,4V



### 3 Fillo

Gjithmonë ndiqni udhëzimet në këtë kapitull në vijim.


#### Ngarkoni baterinë e integruar

Radioja furnizohet me energji nga një bateri e rikarikueshme e cila vjen e integruar.

##### Shënim

- Kur fuqia e baterisë është e ulët, shfaqet një ikonë '🔋'. Ju lutemi rikarikoni baterinë e integruar sa më shpejt të jetë e mundur.

Lidhni portën TYPE-C të radios me një burim energjie (5V = 2A) duke përdorur kabllon e furnizuar.



↳ Kur radioja është duke u ngarkuar, shfaqet ikona '🔋'.

↳ Kur radioja është plotësisht e ngarkuar, shfaqet ikona '🔋'.

##### Shënim

- Ju lutem kini parasysh se radioja juaj përmban bateri litiumi të integruara. Kapaciteti i karikimit të baterive të litiumit do të ulet me kalimin e kohës për shkak të karakteristikave të tyre vetë-shkarkuese. Për të siguruar jetëgjatësinë e baterisë së radios suaj, ne rekomandojmë **karikimin e baterisë së integruar të litiumit në rreth 50% çdo 6 muaj gjatë periudhave kur radioja nuk është në përdorim.**

#### Ndizeni/fikeni ose kaloni në modalitetin e pritjes

- Shtypni për të ndezur radion ose për të kaluar në modalitetin e pritjes.  
↳ Radioja kalon te burimi i fundit i përzgjedhur ose shfaq orën (nëse është vendosur).
- Shtypni dhe mbani shtypur për të fikur radion.


##### Shënim

- Nëse Bluetooth nuk është i lidhur për më shumë se 15 minuta ose është i lidhur por nuk është aktiv, radioja do të kalojë automatikisht në modalitetin e pritjes.
- Në çdo modalitet, shtypni dhe mbani shtypur për tre sekonda për ta fikur direkt radion. Ekranin fiket.

#### Zgjidhni gjuhën e menisë


- 1 Shtypni për të hyrë në menu.
- 2 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [System], më pas shtypni për të konfirmuar.
- 3 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Language], më pas shtypni për të konfirmuar.
- 4 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur gjuhën e shfaqjes së menisë, më pas shtypni për të konfirmuar.  
English/Deutsch/Italiano/Français/Norsk/Dansk/Nederlands Svenska/Español/Suomi/PolSKI
- 5 Shtypni për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Mund ta ndryshoni gjuhën edhe nëpërmjet aplikacionit Philips Entertainment (te seksioni Cilësimet e Përgjithshme).














#### Rregulloni volumin

Rrotulloni dorezën majtas/djathtas për të ulur/rritur volumin gjatë dëgjimit të radios/muzikës. Gjithashtu, nëpërmjet aplikacionit mund të rregulloni volumin, të zgjidhni një modalitet zëri dhe të aktivizoni ose çaktivizoni funksionin Bass+.




## Rregulloni ndriçimin e ekranit


Mund të përzgjidhni nivele të ndryshme të ndriçimit të ekranit.

- 1 Shtypni  për të hyrë në menu.
- 2 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  /  për të zgjedhur [Display] dhe më pas shtypni  për të konfirmuar.
- 3 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  /  për të zgjedhur opsionin [Backlight level], dhe më pas shtypni  për të konfirmuar.
- 4 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  /  për të zgjedhur nivelin e ndriçimit (1 lartë, Mesatar, 1 ulët) në ekranin e shfaqur dhe më pas shtypni  për të konfirmuar.
- 5 Shtypni  për të dalë nga menuja.

Gjithashtu mund të rregulloni ndriçimin e ekranit përmes Aplikacionit.








## Standby



## Shfaqja e menisë në modalitetin e pritjes

Kur radioja është në modalitetin e pritjes, mund të përdorni

- 1 Në modalitetin e pritjes, shtypni  për të hyrë në menu.
- 2 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  /  për të zgjedhur një opsion nga menuja dhe më pas shtypni  për të konfirmuar opsionin ose për të hyrë në menunë e nivelit më të ulët.
  - [Display]: rregulloni cilësimet e ndriçimit të ekranit/ funksionin e errësimit/kohën e fikjes automatike të ekranit.
  - [Alarm]: vendosni ndezjen/fikjen e alarmit 1 ose 2 dhe konfigurimin e alarmit.
  - [Clock]: vendosni sinkronizimin e kohës, datën/orën, zgjidhni formatin e kohës dhe formatin e datës.
  - [System]: rregulloni parametrat e sistemit.
- 3 Për hollësi mbi nën-opsionet, shihni strukturën hierarkike të menisë në faqen tjetër.
- 4 Shtypni  për të kthyer në modalitetin e pritjes.

## 4 Cilësimi/konfigurimi i orës

### Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 30 sekondave, menuja do të mbyllet automatikisht.

### Vendosja automatike e orës

- Shtypni  $\equiv$  për të hyrë në menu.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Clock], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Set auto/manual], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Auto(RDS)], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Shtypni  $\equiv$  për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Në stacionin FM RDS, radioja mund të sinkronizohet automatikisht me orën e transmetuar nga stacioni FM RDS (kur disponohet informacioni CT).

### Vendosja manuale e orës

- Shtypni  $\equiv$  për të hyrë në menu.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Clock], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Set date&time], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur orën, më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur minutën, më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur muajin, më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur ditën, më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur vitin, më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.

↳ Ora është vendosur me sukses.

- Shtypni  $\equiv$  për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

### Vendosni formatin e kohës

- Shtypni  $\equiv$  për të hyrë në menu.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Clock], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Set 12H/24H], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [12H] ose [24H], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Shtypni  $\equiv$  për t'u kthyer në menunë e mëparshme.



### Vendosni formatin e dates

- Shtypni  $\equiv$  për të hyrë në menu.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Clock], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Set date format], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur formatin e datës [MM-DD-YYYY], [DD-MM-YYYY] ose [YYYY-MM-DD], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Shtypni  $\equiv$  për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

### Stili i orës

- Shtypni  $\equiv$  për të hyrë në menu.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Clock], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Clock style], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  $\ll / \gg$  për të zgjedhur [Classic analog] ose [Normal digital], më pas shtypni  $\odot$  për të konfirmuar.
- Shtypni  $\equiv$  për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

Gjithashtu ju mund të caktoni orën dhe datën e orës nëpërmjet Aplikacionit (te Clock Setting dhe Date Settings).



## 5 Vendosja e alarmit



### Shënim

- Sigurohuni që ta keni vendosur orën në mënyrë korrekte dhe të saktë.

### Vendosja e kohës së alarmit

- 1 Shtypni për të hyrë në menu.
- 2 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Alarm], më pas shtypni .
- 3 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Alarm 1 Setup] ose [Alarm 2 Setup], më pas shtypni për të konfirmuar.
- 4 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur opsionin [Frequency], më pas shtypni për të konfirmuar, do të pulsojë cikli i përsëritjes së alarmit.
- 5 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur ciklin e përsëritjes së alarmit (Një herë, Përditë, Ditë Pune ose Modaliteti Fundjavë), më pas shtypni për të konfirmuar.
- 6 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Wake up time], pastaj shtypni për ta konfirmuar. Ora do të pulsojë.
- 7 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur orën, më pas shtypni për të konfirmuar. Minuta do të pulsojë.
- 8 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të vendosur për të vendosur minutat, më pas shtypni për ta konfirmuar.
  - Nëse është zgjedhur [Once] si periudha e alarmit, ju lutemi përdorni / dhe për të vendosur datën e alarmit.
- 9 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Source], më pas shtypni për të konfirmuar.
- 10 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur burimin e alarmit, (Buzzer ose stacioni FM), më pas shtypni për të konfirmuar.
  - Nëse [FM] zgjidhet si burim alarmi (parazgjedhja është BUZZER), menuja Alarm do të ketë një opsion shtesë [Preset], ju lutemi përdorni / dhe për të zgjedhur numrin e stacionit radiofonik të paracaktuar (të ruajtur paraprakisht).
- 11 Shtypni për t'u kthyer në menunë e mëparshme.
  - ↳ Do të shfaqet ikona përkatëse e alarmit / .



### Këshillë

- Nëse nuk kryhet asnjë veprim për 30 sekonda, radioja del automatikisht nga modaliteti i vendosjes së alarmit.
- Nëse FM zgjidhet si burim alarmi, por stacioni i paracaktuar nuk është zgjedhur, SINJALIZUESI ZANOR aktivizohet automatikisht.
- Alarmi fiket automatikisht pas 60 minutash nëse nuk ndërmerren veprime nga përdoruesi.
- Mund t'i vendosni alarmet edhe nëpërmjet Aplikacionit (shihni Clock Setting).

### Aktivizoni/çaktivizoni kohëmatësin e alarmit

- 1 Shtypni për të hyrë në menu.
- 2 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Alarm], më pas shtypni për të konfirmuar.
- 3 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Alarm 1] ose [Alarm 2], më pas shtypni për të konfirmuar.
- 4 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [On] ose [Off], më pas shtypni për të konfirmuar aktivizimin ose çaktivizimin e kohëmatësit të alarmit.
- 5 Shtypni për t'u kthyer në menunë e mëparshme.
  - ↳ Nëse kohëmatësi i alarmit është i aktivizuar, do të shfaqet ikona / .
  - ↳ Nëse kohëmatësi i alarmit është i çaktivizuar, ikona / do të zhduket.

## 6 Dëgjoni radion FM



### Shënim

- Mbajeni radion larg pajisjeve të tjera elektronike për të shmangur interferencat në sinjalin e radios.
- Për një marrje më të mirë të sinjalit, zgjateni plotësisht antenën FM dhe rregulloni pozicionin e saj.

### Sintonizimi automatik

- 1 Shtypni për të ndezur radion.
- 2 Shtypni për të zgjedhur modalitetin FM.
- 3 Shtypni dhe mbajeni shtypur / për 3 sekonda.
  - ↳ Radioja sintonizohet automatikisht me një stacion me sinjal marrës të fortë.

### Kërkimi manual

Shtypni / për zgjedhjen e një frekuence për t'u sintonizuar manualisht në një stacion të caktuar.



### Shënim

- Rrjeti i sintonizimit të radios është 50KHz. Frekuenca e radios në panelin e ekranit do të rritet me 0,05MHz duke shtypur / .

### Kërkoni dhe ruani automatikisht stacionet e radios FM



### Shënim

- Ju mund të ruani maksimumi 30 stacione radio FM.

Në modalitetin e sintonizuesit FM, shtypni dhe mbani shtypur për tre sekonda.

- ↳ Shfaqet [Auto Scanning...].
- ↳ Radioja skanon dhe ruan automatikisht të gjitha stacionet e radios FM dhe më pas transmeton stacionin e parë të disponueshëm.


### Ruani në mënyrë manuale stacionet e radios me valë FM

- 1 Në modalitetin e sintonizuesit FM, sintonizohuni në një stacion radioje FM.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur për tre sekonda që të aktivizohet modaliteti i programimit.
  - ↳ Lista e paracaktuar shfaqet në ekran.
- 3 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur numrin.
- 4 Shtypni për të ruajtur stacionin e paracaktuar.
- 5 Përsëritni hapat 1 deri në 4 për të ruajtur më shumë stacione radioje FM.



### Këshillë

- Për të hequr një stacion të paracaktuar, ruani një stacion tjetër në vendin e tij nëse sasia e paracaktuar është mbi 30.
- Gjithashtu mund të zgjidhni burimin FM dhe të ruani stacionet e paracaktuara nëpërmjet Aplikacionit (në Source Control).



- [Display]: rregulloni cilësimet e ndriçimit të pasmë/ funksionin e errësimit/kohën e fikjes automatike të ekranit.
  - [Alarm]: vendosni alarmin në/çaktivizoni dhe konfiguroni alarmin.
  - [Clock]: vendosni sinkronizimin e kohës, datën/orën, zgjidhni formatin e kohës dhe formatin e datës.
  - [System]: rregulloni parametrat e sistemit.
- 3 Përsëritni Hapin 2 nëse ka nën-opione të disponueshme brenda një opsioni.
  - 4 Shtypni ≡ për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

#### Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 30 sekondave, menyja mbyllet.

## Zgjidhni një stacion radioje të paracaktuar

- 1 Në modalitetin e sintonizuesit FM, shtypni ♥.
- 2 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni ◀◀ / ▶▶ për të zgjedhur një stacion radioje të paracaktuar.

#### Shënim

- Pas tre sekondash, stacioni i paracaktuar i radios do të konfirmohet automatikisht. Ose shtypni dorezën rrotulluese për të konfirmuar zgjedhjen dhe për të filluar transmetimin.

## Cilësimi i ndjeshmërisë së skanimit

- 1 Shtypni ≡ për të hyrë në menunë FM.
- 2 Shtypni ⦿ për të hyrë në [Scan setting].
- 3 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni ◀◀ / ▶▶ për të zgjedhur [Strong] (vetëm stacione të forta) ose [All] (të gjitha stacionet), pastaj shtypni ⦿ për të konfirmuar.
- 4 Shtypni ≡ për të dalë nga menuja.

## Shfaq informacionin RDS

RDS (Sistemi i të Dhënave Radio) është një shërbim që iu mundëson stacioneve FM të shfaqin informacion shtesë.


- 1 Sintonizoni me një stacion FM RDS.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur ≡ për tre sekonda për shfaqjen e informacionit të mëposhtëm (nëse është i disponueshëm):
  - ↳ Emri i stacionit
  - ↳ Lloji i programit si p.sh. [NEWS] (lajme), [SPORT] (sport), [POP M] (muzikë pop)...
  - ↳ Koha
  - ↳ Teksti
  - ↳ Frekuenca

## Shfaq menunë në modalitetin FM

Gjatë kohës që dëgjoni FM, mund të hyni në menu për opsionet e kontrollit.

- 1 Shtypni ≡ për të hyrë në menunë FM.
- 2 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni ◀◀ / ▶▶ për të zgjedhur një opsion nga menuja dhe më pas shtypni ⦿ për të konfirmuar opsionin ose për të hyrë në menunë e nivelit më të ulët.
  - [Scan setting]: zgjidhni ndjeshmërinë e skanimit (vetëm stacione të forta ose të gjitha stacionet).
  - [Sound style]: përcaktoni profilin e përpunimit/përmirësimit të tingullit: Balanced/Warm/Bright/Powerful/Clear.
  - [Bass+]: zgjidhni nëse funksioni Bass+ do të jetë i aktivizuar ose i çaktivizuar.
  - [Kitchen timer]: caktoni kohëmatësin e kuzhinës.
  - [Sleep timer]: vendosni kohëmatësin e gjumit.

## FM Menu




## 7 Dëgjoni muzikë me Bluetooth®

### Shënim





- Rrezja e funksionimit ndërmjet radios dhe pajisjes është afërsisht 25 metra (në hapësirë të hapur).
- Përputhshmëria me të gjitha pajisjet Bluetooth® nuk është e garantuar.
- Prania e çdo pengese midis pajisjes dhe radios mund të reduktojë distancën e funksionimit.
- Mbajeni këtë radio larg pajisjeve të tjera elektronike që mund të shkaktojnë ndërhyrje.
- Lidhja me radion do të ndërpritet gjithashtu kur pajisja juaj të dalë jashtë rrezes së funksionimit.

### Lidhni Bluetooth®









- 1 Shtypni  disa herë për të kaluar në modalitetin Bluetooth. Mund të kaloni edhe në modalitetin Bluetooth nëpërmjet Aplikacionit (në Source Control).
  - ↳ Do të shfaqet [Not Connected].
- 2 Në pajisjen tuaj Bluetooth, aktivizoni Bluetooth, kërkoni [THE JANET XL] për të filluar lidhjen.
  - Nëse lidhet me sukses:
    - ↳ Ju do të dëgjoni një sinjal të menjëhershëm.
    - ↳ Do të shfaqet [Connected].

### Shkëput Bluetooth®-in

- Kaloni në një burim tjetër në radio; Ose
- Çaktivizoni funksionin nga pajisja juaj Bluetooth®. Nëse shkëputja është e suksesshme:
  - ↳ Ju do të dëgjoni një sinjal të menjëhershëm.
  - ↳ Do të shfaqet [Not connected].
- Ose




  - 1 Shtypni  për të hyrë në menunë Bluetooth.
  - 2 Shtypni  për të zgjedhur [Bluetooth pair].
  - 3 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  /  për të zgjedhur [Yes] (shkëputni Bluetooth®-in dhe hyni në gjendjen e çiftimit), pastaj shtypni dorezën për ta konfirmuar.

### Fshini të dhënat e çiftimit Bluetooth®

- 1 Shtypni  për të hyrë në menunë Bluetooth.
- 2 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  /  për të zgjedhur [Bluetooth clean], më pas shtypni  për ta konfirmuar.
- 3 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  /  për të zgjedhur [Yes] nëse dëshironi të fshini historikun e çiftimit Bluetooth, ose [No] për të mbajtur lidhjen aktuale; më pas shtypni  për ta konfirmuar.
- 4 Shtypni  për të dalë nga menuja.
  - ↳ Do të shfaqet [Not connected].





### Luaj muzikë

Gjatë riprodhimit të muzikës në pajisjen tuaj Bluetooth®, mund ta përdorni këtë radio për të kontrolluar riprodhimin e muzikës.

- Shtypni  për të ndalur përkohësisht ose për të rifilluar riprodhimin.
- Shtypni  /  për të kaluar te një këngë tjetër.
- Rrotulloni dorezën për të rregulluar volumnin.

### Shfaq menunë në modalitetin Bluetooth®

Kur dëgjoni nëpërmjet Bluetooth®, mund të hyni në menu për opsionet e kontrollit.

- 1 Shtypni  për të hyrë në menunë Bluetooth®.
- 2 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni  /  për të zgjedhur një opsion nga menuja dhe më pas shtypni  për të konfirmuar opsionin ose për të hyrë në menunë e nivelit më të ulët.
  - [Bluetooth pair]: zgjidheni atë për të shkëputur lidhjen Bluetooth dhe për të hyrë në modalitetin e çiftimit.

- [Bluetooth clean]: fshini të dhënat e çiftimit Bluetooth.
- [Sound style]: përcaktoni profilin e përpunimit/përmirësimit të tingullit: Balanced/Warm/Bright/Powerful/Clear.
- [Bass+]: zgjidhni nëse funksioni Bass+ do të jetë i aktivizuar ose i çaktivizuar.
- [Kitchen timer]: caktoni kohëmatësin e kuzhinës.
- [Sleep timer]: vendosni kohëmatësin e gjumit.
- [Display]: rregulloni cilësimet e ndriçimit të pasmë/ funksionin e errësimit/kohën e fikjes automatike të ekranit.
- [Alarm]: vendosni alarmin në/çaktivizoni dhe konfiguroni alarmin.
- [Clock]: vendosni sinkronizimin e kohës, datën/orën, zgjidhni formatin e kohës dhe formatin e datës.
- [System]: rregulloni parametrat e sistemit.


3 Përsëritni Hapin 2 nëse ka nën-opione të disponueshme brenda një opsioni.

4 Shtypni ≡ për t'u kthyer në menunë e mëparshme.

### Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 30 sekondave, menyja mbyllet.





### Bluetooth Menu




## Riprodhoni nga Auracast™

Mund të luani audio nga pajisja juaj Bluetooth që mbështet Auracast ose transmetues të tjerë Auracast në radio, dhe gjithashtu mund ta çiftoni radio-orën me një ose më shumë autoparlantë të aktivizuar për Auracast duke përdorur teknologjinë Auracast.


### Kontrolli i Auracast RX (Marrja e audios)

- 1 Shtypni butonin  në radio ose aktivizojeni nëpërmjet aplikacionit Philips Entertainment (në Source control > Auracast receiver).  
↳ [Scanning] do të shfaqet në ekran.
- 2 Radioja do të kërkojë transmetimet Auracast që ndodhen pranë dhe do të lidhet me transmetimin e parë të pakriptuar që gjen gjatë skanimit. (Pajisja juaj celulare që mbështet Auracast TX mund të përdoret si transmetues.  
Aktivizoni transmetimin Auracast në pajisjen tuaj celulare në mënyrë që radioja të mund ta zbulojë atë gjatë skanimit.)  
↳ Për të dëgjuar një transmetim të enkriptuar, duhet të vendosni një fjalëkalim në aplikacion.
- 3 Shtypni  /  për të kaluar në transmetimet e radhës.
- 4 Nëse dëshironi të kryeni një skanim të ri për transmetimet në modalitetin Auracast RX, shtypni edhe një here .  
↳ [Scanning] do të shfaqet në ekran.


### Shënim


- Nëse gjatë skanimit nuk gjendet asnjë transmetim Auracast brenda 10 sekondave, skanimi do të ndalet dhe radioja do të kalojë në modalitetin e mosveprimit.  
↳ Në ekran do të shfaqet [No Auracast broadcast found].
- Nëse transmetimi Auracast shkëputet për 10 sekonda, radioja do të hyjë në modalitetin e mosveprimit.  
↳ Në ekran do të shfaqet [No signal].
- Kur shtypni butonin  në gjendje pritjeje, nëse burimi i fundit ka qenë Auracast RX, radioja do të kryejë një skanim Auracast dhe do të lidhet me transmetimin e parë të pakriptuar që zbulon.

Për të dalë nga modaliteti Auracast RX:

Shtypni  për ta kaluar radionë në një burim tjetër. Gjithashtu mund të ndërtoni burimin përmes Aplikacionit (në Source control).



### Kontrolli i Auracast TX (Transmetimi i audios)

- 1 Përdoreni këtë radio si autoparlantin kryesor (transmetuesin Auracast). Riprodhoni audio nga një burim Bluetooth ose FM.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin  në radio për 3 sekonda ose aktivizojeni përmes aplikacionit Philips Entertainment (në General Settings > Auracast broadcaster) për të kaluar në modalitetin Auracast TX.  
↳ Në ekran do të shfaqet mesazhi [Auracast Broadcaster On].  
↳ Nëse dëshironi ta konfiguroni radionë si një burim transmetimi të kriptuar, zgjidhni opsionin "Personal" për transmetuesin Auracast dhe futni një fjalëkalim në Aplikacion. (Opsioni i paracaktuar është "Public".)  
↳ Nëse radioja është përdorur më parë si transmetues i kriptuar, transmetimi do të rifillojë automatikisht.



- 3 Aktivizoni Auracast RX në një pajisje tjetër që mbështet Auracast (si autoparlant dytësor).
- 4 Pasi transmetimi Auracast nga radioja të zbulohet nga autoparlanti dytësor, audioja që transmetohet në radio do të sinkronizohet me autoparlantin dytësor.  
↳ Në këtë mënyrë mund të lidhni me radionë disa pajisje që mbështesin Auracast.

### Shënim

- Shtypni dhe mbani shtypur  për 8 sekonda për të fshirë informacionin e transmetimit të kriptuar që keni konfiguruar. Mund ta fshini informacionin edhe nëpërmjet Aplikacionit.  
↳ Mesazhi [Clear private info] do të shfaqet për 3 sekonda, pas së cilit do të shfaqet informacioni i burimit aktual.
- Në modalitetin Auracast TX, shtypni  për të kaluar në një burim tjetër për transmetim. Burimin mund ta ndryshoni gjithashtu përmes Aplikacionit.

Për të dalë nga modaliteti Auracast TX:

shtypni dhe mbani shtypur butonin  në radio për 3 sekonda ose dilni nga ky modalitet përmes Aplikacionit.

- ↳ Në ekran do të shfaqet mesazhi [Auracast Broadcaster Off]. Radioja do të mbetet në burimin aktual të audios.

## 8 Veçori të tjera


### Vendos kohëmatësin e kuzhinës

#### Shënim

- Nëse nuk kryhet asnjë veprim për 30 sekonda, radioja do të dalë automatikisht nga menuja e cilësimeve.

- Shtypni për të ndezur radion.
- Shtypni për të hyrë në menu.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Kitchen timer], më pas shtypni për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Kitchen timer setup], më pas shtypni për të konfirmuar.  
↳ Numrat e orës pulsojnë.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të vendosur orën dhe më pas shtypni për të konfirmuar.  
↳ Numrat e minutave fillojnë të pulsojnë.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të vendosur minutën, dhe më pas shtypni për të konfirmuar.  
↳ Numrat e sekondave fillojnë të pulsojnë.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të vendosur sekondën, dhe më pas shtypni për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [On/Off], më pas shtypni për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [On] ose [Off] kohëmatësin e kuzhinës, dhe më pas shtypni për të konfirmuar.
- Shtypni për t'u kthyer në menunë e mëparshme.  
↳ Shfaqen ikona dhe kohëmatësi i kuzhinës.

Gjithashtu mund të konfiguroni kohëmatësin e kuzhinës dhe kohëmatësin e fikjes automatike përmes aplikacionit (te Clock Setting).



#### Shënim

- Koha e skadimit të kohëmatësit të kuzhinës është 60 minuta në mungesë të një veprimi nga përdoruesi.

### Ndaloni tingujt e kohëmatësit të kuzhinës

Kur bie tingulli i kohëmatësit të kuzhinës, shtypni çdo tast për të ndaluar zilen.

### Anuloni kohëmatësin e kuzhinës


- Nëse dëshironi të anuloni kohëmatësin e kuzhinës, shtypni për të hyrë në menu.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Kitchen timer], më pas shtypni për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [On/Off], më pas shtypni për të konfirmuar.
- Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Off], më pas shtypni për të konfirmuar.
- Shtypni për të dalë nga menuja.

#### Shënim

- Kohëmatësi i kuzhinës mund të anulohet vetëm kur radioja është e ndezur.

### Telekomanda virtuale (vetëm përmes aplikacionit)


Mund të përdorni telekomandën virtuale për të kontrolluar riprodhimin e muzikës ose për radio, si dhe për të rregulluar cilësime të tjera të radios.



## Përditësimi i firmuerit


Kur në ekran shfaqen njoftime ose kur në ikonën "i" në aplikacion shfaqet një pikë e kuqe, kjo tregon se është i disponueshëm një version i ri i firmuerit për përditësim.

Ndiqui udhëzimet e shfaqura për të përfunduar përditësimin.



## Udhëzuesi i përdoruesit

Drëshqitni ikonat e menisë majtas derisa të gjeni ikonën . Shtypni për të kontrolluar manualin e përdoruesit dhe udhëzuesin e shpejtë të nisjes për më shumë informacion rreth përdorimit të këtij autoparlanti.



## Rikthim në gjendjen e parametrevë të vendosur nga fabrika

- 1 Shtypni për të hyrë në menu.
- 2 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [System], më pas shtypni për të konfirmuar.
- 3 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Factory reset], më pas shtypni për të konfirmuar.
- 4 Rrotulloni dorezën rrotulluese ose shtypni / për të zgjedhur [Yes] (rivendosni të gjitha cilësimet e radios në gjendjen fillestare të fabrikës), më pas shtypni për të konfirmuar.

↳ Shfaqet [Restarting...].

## 9 Specifikat e produktit

### Shënim

- Informacioni i produktit është subjekt i ndryshimit pa njoftim paraprak.

### Përforcues (Amplifikator)

Fuqia e vlerësuar e daljes 20W (RMS)

### Autoparlant

Woofer 2,75"

Tweeter 25mm

### Sintonizues

Diapazoni i sintonizimit (FM) 87,5 ~ 108MHz

Rrjeti i sintonizimit 50 kHz

Ndjeshmëria  
- Mono, raporti S/N 26 dB < 22 dBf

Shtrembërimi harmonik total < 10%

Raporti sinjal zhurmë > 50 dBA

### Bluetooth

Versioni i Bluetooth V6.0

Brezi i frekuencës Bluetooth 2,4 GHz~2,48 GHz

Maks. e.i.r.p. 9dBm

Rrezja e shtrirjes së Bluetooth 25 m (zone e hapur)

### Informacion i përgjithshëm

Porta USB 5V ⇄ 2A

Bateri litiumi 7,3 V/2600 mAh

Përmasat (Gja x L x Gjë) 230 x 132,4 x 85 mm

Pesha (njësia kryesore) 1,32 Kg

## 10 Zgjidhja e problemeve

### Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kutinë e produktit.

Për të ruajtur vlefshmërinë e garancisë, mos u përpini kurrë ta riparoni vetë pajisjen. Nëse hasni probleme gjatë përdorimit të kësaj njësie, kontrolloni pikat e mëposhtme përpara se të kërkonti shërbim. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja të jetë pranë jush dhe të dispononi numrin e modelit dhe numrin serial.

### Nuk ka energji

- Sigurohuni që radioja të jetë e karikuar plotësisht.
- Sigurohuni që porta USB e radios të jetë lidhur siç duhet.

### Nuk ka zë

- Rregulloni volumin në këtë radio.
- Rregulloni volumin në pajisjen e lidhur.
- Sigurohuni që pajisja juaj Bluetooth të jetë brenda intervalit operativ.

### Nuk ka përgjigje nga radioja.

- Fikeni dhe ndizeni përsëri radion.

### Marrje e dobët e sinjalit radio

- Mbajeni radion larg pajisjeve të tjera elektronike për të shmangur interferencat në sinjalin e radios.
- Shtrijeni plotësisht dhe rregulloni pozicionin e antenës.

### Alarmi nuk funksionon

- Vendosni orën/alarmin në mënyrë korrekte.


### Cilësimet e orës/alarmit janë fshirë.

- Rivendosni orën/alarmin.
- Zëvendësoni bateritë rezervë.

### Cilësia e audios është e dobët pas lidhjes me një pajisje të aktivizuar me Bluetooth

- Marrja me Bluetooth është e dobët. Lëvizni pajisjen më afër këtij autoparlanti ose largoni çdo pengesë midis tyre.

### Nuk u gjet [The Janet XL] në pajisjen tuaj Bluetooth për çiftim

- Shtypni  disa herë për të kaluar në modalitetin Bluetooth dhe më pas provojeni përsëri.

### Nuk mund të lidhet me pajisjen tuaj Bluetooth

- Funksioni Bluetooth i pajisjes nuk është i aktivizuar. Referojuni manualit të përdorimit të pajisjes suaj për të zbuluar se si duhet aktivizuar funksioni.
- Kjo radio nuk është në modalitetin e çiftimit.
- Kjo radio është tashmë e lidhur me një pajisje tjetër me Bluetooth të aktivizuar.
- Shkëputeni dhe provoni përsëri.

### Disa stacione ndonjëherë nuk funksionojnë

- Disa stacione mund të mbështesin vetëm një numër të kufizuar dëgjuesish. Nëse provoni përsëri pas disa minutash, do të mund t'i dëgjoni ato (stacionet).
- Stacioni nuk po transmeton. Provoni përsëri më vonë.

### Disa stacione zhduken nga lista e stacioneve

- Kur një stacion ndalon transmetimin, ai do të hiqet nga lista. Radioja do të kontrollojë vazhdimisht nëse stacioni është në transmetim. Nëse rifillon transmetimin, ai do të rikthehet në listën e stacioneve.

### Bateria nuk mund të ngarkohet siç duhet ose bateria zbrazet shumë shpejt

- Zëvendësoni baterinë (shihni Kapitullin 2).

## 11 Informacioni i FCC

Kjo pajisje përputhet me Pjesën 15 të Rregullave FCC. Funksionimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

(1) kjo pajisje nuk mund të shkaktojë ndërhyrje të dëmshme dhe (2) kjo pajisje duhet të pranojë çdo ndërhyrje të marrë, duke përfshirë ndërhyrjen që mund të shkaktojë funksionim të padëshiruar.

**SHËNIM:** Kjo pajisje është testuar dhe është gjetur se përputhet me kufizimet për një pajisje dixhitale të Klasit B, në përputhje me Pjesën 15 të Rregullave FCC. Këto kufizime janë krijuar për të siguruar mbrojtje të arsyeshme kundër ndërhyrjeve të dëmshme në një instalim banesë. Kjo pajisje gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji radiofrekuence dhe, nëse nuk instalohet dhe përdoret në përputhje me udhëzimet, mund të shkaktojë ndërhyrje të dëmshme në komunikimet radio.

Sidoqoftë, nuk ka asnjë garanci që nuk do të ketë ndërhyrje në një instalim të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton ndërhyrje të dëmshme në marrjen e radios ose televizionit, e cila mund të përcaktohet duke fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi inkurajohet të përpiqet për korrigjimin e ndërhyrjes duke përdorur një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Riorientoni ose zhvendosni antenën marrëse. Rritni ndarjen midis pajisjes dhe marrësit.
- Futeni pajisjen në një prizë në një qark të ndryshëm nga ai me të cilin është lidhur marrësi.
- Konsultohuni me tregtarin ose një teknik me përvojë radio/TV për ndihmë.

### IC-Kanada: CAN ICES (B)/NMB (B)

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licenca që përputhen me përjashtimin nga licenca për Inovacionin, Shkencën dhe Zhvillimin Ekonomik të Kanadasë. Funksionimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

- Kjo pajisje mund të mos shkaktojë ndërhyrje.
- Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë, duke përfshirë edhe interferencën që mund të shkaktojë funksionim të padëshiruar të pajisjes.

### Deklarata e ekspozimit ndaj rrezatimit FCC & IC

- Kjo pajisje përputhet me kufijtë e ekspozimit ndaj rrezatimit të vendosur nga FCC dhe Kanadaja të përcaktuara për një mjedis të pakontrolluar.
- Kjo pajisje duhet të instalohet dhe të përdoret me një distancë minimale 20 cm ndërmjet radiatorit dhe trupit tuaj.
- Ky transmetues nuk duhet të bashkë-vendoset ose të përdoret në lidhje me ndonjë antenë ose transmetues tjetër.

### PARALAJMËRIM

Ndryshimet ose modifikimet në këtë njësi të pa miratuara shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund të anulojnë autoritetin e përdoruesit për të përdorur pajisjen.

### Avis d'Industrie Canada: CAN ICES-(B)/NMB-(B)

L'émetteur/récepteur exempt de licence contenu dans le présent appareil est conforme aux CNR d'Innovation, Sciences et Développement économique Canada applicables aux appareils radio exempts de licence.

L'exploitation est autorisée aux deux conditions suivantes :

1. L'appareil ne doit pas produire de brouillage;
2. L'appareil doit accepter tout brouillage radioélectrique subi, même si le brouillage est susceptible d'en compromettre le fonctionnement.

Deklarata e ekspozimit ndaj rrezatimit: Ky produkt përmbush standardet kanadeze për kufirin e ekspozimit ndaj rrezatimit RF për pajisje portative në një mjedis të pakontrolluar dhe është i sigurt për përdorimin e parashikuar, sipas udhëzimeve të këtij manuali.

Déclaration d'exposition aux radiations: Le produit est conforme aux limites d'exposition pour les appareils portables RF pour les Etats-Unis et le Canada établies pour un environnement non contrôlé.



Specifikimet mund të ndryshojnë pa paralajmërim.  
2026 © Philips dhe stema Philips Shield janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë.  
Ky produkt është prodhuar dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited ose një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi në lidhje me këtë produkt.

TAV2500F\_UM\_SQ\_V1.0

